



Republika e Kosovës

Ministria e Financave

KKRF- Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar KCFR

Kosovo Financial Reporting Council KSFI

Kosovski Savet za Financijko Izveštavanje

Bazuar në nenin 9, paragrafi 1, neni 22 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) nxjerr:

## UDHËZIM ADMINISTRATIV NR 01/2020 PËR RAPORTIMET FINANCIARE VJETORE TË MIKRO NDËRMARRJEVE

### Neni 1

#### Qëllimi

1. Qëllimi këtij udhëzimi administrativ është të përcaktoj përbajtjen dhe dorëzimin e raportimeve financiare vjetore të mikro ndërmarrjeve të klasifikuara sipas nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim si dhe nenit 9, paragrafi 5, i Udhëzimit Administrativ Mf-Nr. 07/2019 Për Strukturën, Përbajtjen dhe Dorëzimin e Raportimeve Financiare Vjetore.

### Neni 2

#### Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij udhëzuesi administrativ janë të obligueshme për shoqëritë tregtare të regjistrues të ARBK dhe të klasifikuara si mikro ndërmarrje sipas nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës dhe janë të obliguara që sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim të përgatisin pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme.

### Neni 3

#### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin si në vijim:

**1.1. Drejtori ekzekutiv - përfshin pozitën e kryeshefit ekzekutiv apo pozitën më të lartë menaxheriale në ndërmarrje dhe i cili është përgjegjës për udhëheqjen e shoqërisë tregtare;**

**1.2. Drejtor finansiar** – përfshin pozitën e drejtorit finansiar apo pozitën më të lartë për financa në ndërmarrje dhe i cili është përgjegjës për udhëheqjen e financave dhe kontabilitetit në shoqëri tregtare; dhe

**1.3. Kontabilist i certifikuar** – personi i kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë e licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (këtu e tutje KKRF), i cili është anëtar me status të rregullt në një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, dhe emri i tij figuron në listën publike të kontabilistëve të certifikuar të publikuar nga shoqatat e licencuara nga KKRF.

2. Shprehjet tjera të përdoruara në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtës sipas Ligjit.

#### Neni 4

##### Klasifikimi i mikro ndërmarrjeve

1. Mikro ndërmarrjet janë ndërmarrje të cilat *nuk i tejkalojnë kufijtë* e së paku dy nga tre kriteret si në vijim:

- (i) pasqyra e pozitës finanziare (totali i aseteve) prej treqind e pesëdhjetë mijë euro (350,000€);
- (ii) qarkullimi (të hyrat) vjetor neto prej shtatë qind mijë euro (700,000€) dhe
- (iii) numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit finansiar: dhjetë (10).

#### Neni 5

##### Nën-klasifikimi i mikro ndërmarrjeve

1. Për qëllime të raportimit finansiar, ndërmarrjet e klasifikuara si mikro, nën-klasifikohen si në vijim:

- 1.1. Klasa I: mikro ndërmarrjet me qarkullim (të hyra) vjetor neto që nuk tejkalojnë vlerën 50,000€.
- 1.2. Klasa II: mikro ndërmarrjet me qarkullim (të hyra) vjetor neto që nuk tejkalojnë vlerën 300,000€ dhe nuk i përkasin klasës I.
- 1.3. Klasa III: mikro ndërmarrjet me qarkullim (të hyra) vjetor mbi vlerën 300,000€ dhe nuk i përkasin klasës I dhe II.

#### Neni 6

##### Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore

1. Mikro ndërmarrjet e klasës I, sipas nenit 5, pikë 1.1, obligohen të përgatisin vetëm *pasqyrën e të ardhurave* për periudhën reportuese. Kjo pasqyrë përgatitet sipas parimit të parasë së gatshme ose parimit akrual të kontabilitetit, në varësi të përzgjedhjes nga vetë ndërmarrja.

2. Mikro ndërmarrjet e klasës II, sipas nenit 5, pika 1.2, obligohen të përgatisin vetëm (*ii) pasqyrën e pozitës financiare* në fund të periudhës raportuese dhe (*ii) pasqyrën e të ardhurave* për periudhën raportuese. Këto pasqyra përgatiten sipas parimit akrual të kontabilitetit.

2.1. Obligohen mikro ndërmarrjet e klasës II, që pasqyrave financiare ti bashkangjesin edhe deklaratën e pajtueshmërisë te nënshkruar nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe zyrtari kryesor financier apo personi përgjegjës për financa, që deklarojnë se ato pasqyra financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtet të pozitës financiare dhe rezultateve të operacioneve.

3. Mikro ndërmarrjet e klasës III, sipas nenit 5, pika 1.3, obligohen të përgatisin pasqyrat financiare vjetore të plota në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Formati i këtyre pasqyrave financiare është përcaktuar në *Shojcën Numër 1 dhe 2* të Udhëzimin Administrativ MF-NR. 07/2019 *Për Strukturën, Përbajtjen dhe Dorëzimin e Raportimeve Financiare Vjetore*.

3.1. Obligohen mikro ndërmarrjet e klasës III, që pasqyrave financiare ti bashkangjesin edhe deklaratën e pajtueshmërisë te nënshkruar nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe zyrtari kryesor financier apo personi përgjegjës për financa, që deklarojnë se ato pasqyra financiare paraqesin pamje te drejtë dhe të vërtet të pozitës financiare, rezultateve te operacioneve dhe rrjedhave të parasë të ndërmarrjes.

4. Pasqyrat financiare të të gjitha mikro ndërmarrjeve duhet të shpalosin edhe (*i) numrin mesatar të të punësuarve gjatë periudhës raportuese*, (*ii) totalin e aseteve dhe totalin e detyrimeve* në datën e fundit të periudhës raportuese si dhe (*iii) bazën apo parimit mbi të cilin janë ndërtuar pasqyrat financiare*.

5. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare sipas parimit akrual, të gjitha mikro ndërmarrjet duhet të respektojnë definicionet e koncepteve dhe parimeve të kontabilitetit të përshkruara në Standardin Ndërkombëtar për Raportim Financiar të Ndëmrarrjeve të Vogla dhe Mesme (SNRF për NVM), Seksioni 2 'Konceptet dhe Parimet e Përgjithshme'.

6. Të gjitha mikro ndërmarrjet duhet të prezantojnë pasqyrat financiare të tyre për vitin aktual si dhe vitin paraprak në pajtueshmëri me parimin e krahasueshmërisë së informacionit kontabël.

## Neni 7

### Nënshkrimi i pasqyrave financiare

1. Pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të nenit 6, paragrafi 1, të këtij udhëzimi administrativ duhet të nënshkruhen nga *drejtori ekzekutiv apo pronari*.

2. Pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të nenit 6, paragrafi 2, të këtij udhëzimi administrativ duhet të nënshkruhen nga (*i) drejtori ekzekutiv* dhe nga (*ii) drejtori financier ose kontabilisti i certifikuar*.

3. Pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të nenit 6, paragrafi 3, të këtij udhëzimi administrativ duhet të nënshkruhen nga (*i) drejtori ekzekutiv* dhe nga (*ii) drejtori financier* dhe *nëse ky i fundit nuk është i certifikuar si kontabilist*, atëherë pasqyrat duhet ti nënshkruaj edhe *kontabilisti i certifikuar*, emri i të cilit figuron në regjistrin publik të kontabilistëve të certifikuar të publikuar nga Shoqatat e Licencuara të Kontabilitetit nga KKRF.

### **Neni 8**

#### **Dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare në KKRF**

1. Të gjitha mikro ndërmarrjet duhet të dorëzojnë në KKRF pasqyrat vjetore financiare jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues. Mikro-ndërmarrjet të cilat kanë obligim të përgatisin pasqyra financiarare të konsoliduara, afatin për dorëzim e kanë jo më vonë se më 30 qershor të vitit vijues.
2. Të gjitha kërkesat sipas këtij neni duhet të dorëzohen në KKRF në formë fizike dhe elektronike.
3. Mos respektimi i kërkesave të këtij neni parasheh masa ndëshkimore të cilat janë të parapara me nenin 36 të Ligjit Nr. 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Audtim.

### **Neni 8**

#### **Shtojcat**


1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë Shtojcat si në vijim:
  - 1.1. Shtoja Nr. 1 - Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare për klasën I të mikro ndërmarrjeve;
  - 1.2. Shtoja Nr. 2 - Modeli ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare për klasën II të mikro ndërmarrjeve;

### **Neni 9**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky udhëzim administrativ është obligativ për pasqyrat financiare të periudhës kontabël 2019 e tutje.

Afrim Maloku



Kryesues i KKRF-së

10.02.2020